

U.K.R.D. Sh.A Nr. 13/4 prot  
D. 28.07.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A  
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE

Nr. 5410 prot.

Korçë, më 28/07/2023

V E N D I M

Nr. 5 datë 28/07/2023

P Ë R

MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË LIKUIDIMIT DHE ÇREGJISTRIMIN E SHOQËRISË

Sot, më datë 28/07/2023, Shoqëria Ujësjiellës Kanalizimeve Korçë Sh.A, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J641031410, mbajti mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. Mbledhja u thirr nga likuidatori i shoqërisë zoti Pandi Qirinxi, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

- Përfundimi i procedurave të likuidimit dhe çregjistrimi i Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizimeve Korçë Sh.A.

**Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vëren:**

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizimeve Korçë Sh.A është shpallur në likuidim në datën 16.03.2023. Vendimi si dhe njoftimet e kreditorëve janë publikuar rregullisht në QKB. Shoqëria nuk ka pasur aktive dhe detyrime, pasi në tërësi aktiviteti ekonomik dhe aktivitet se bashku me detyrimet janë transferuar në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizimeve Korçë Sh.A. në datë 31.10.2022.

Pasi u shqyrtua Bilanci në çastin e hapjes së likuidimit i datës 16.03.2023, si dhe pasi u shqyrtua Bilanci përfundimtar i mbylljes së procedurave të likuidimit i datës 30.06.2023 si dhe Raporti i likuidatorit, konkludohet se shoqëria nuk disponon me asete dhe nuk ka detyrime ndaj të tretëve apo ndaj autoriteteve publike. Gjithashtu, shoqëria nuk zhvillon më aktivitet ekonomik dhe në këtë mënyrë mund të deklarohet mbyllja e procedurave të likuidimit dhe shoqëria mund të çregjistrohet.

**Pasi diskutoi gjerësisht mbi çështjen më sipër të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve unanimisht**

**V E N D O S I :**

- (1) Miratimin e bilancit të gjendjes në çastin e hapjes së likuidimit në datë 16.03.2023 si dhe pasqyrave financiare për periudhën 1 Janar 2023 deri 16 Mars 2023 si dhe rezultatit financiar prej 0 (zero) lekë për këtë periudhë
- (2) Miratimin e bilancit të gjendjes në çastin e mbylljes së likuidimit në datë 30.06.2023 si dhe pasqyrave financiare për periudhën 16 Mars 2023 deri 30 Qershor 2023, si dhe rezultatit financiar prej 0 (zero) lekë për këtë periudhë.
- (3) Miratimin e raportit të likuidatorit të datës 30 Qershor 2023
- (4) Të drejtat ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Korçë Sh.A. kalojnë në favor të aksionarit.

<b>Aksionari</b>	<b>Përqindja e pjesëmarrjes</b>	<b>Vlera në Lekë e të drejtave në SHRUK Korçë SHA</b>
Bashkia Korçë	100%	406,069,900
<b>TOTAL</b>	<b>100%</b>	<b>406,069,900</b>

- (5) Mbylljen e fazës së likuidimit, prishjen e shoqërisë dhe çregjistrimin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
- (6) Ngarkohet likuidatori me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E AKSIONAREVE TË UKKO SH.A**

**SOTIRAO FILO**

